



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 03/L-027**

**PËR TAKSËN E AKOMODIMIT NË OBJEKTE HOTELIERE E TURISTIKE**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Me qëllim të rregullimit themelor të pagesës së taksës për shërbime të akomodimit në objekte hoteliere e turistike,

Miraton

**LIGJ PËR TAKSËN E AKOMODIMIT NË OBJEKTE HOTELIERE E TURISTIKE**

**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

1 Me këtë ligj rregullohen përcaktimi dhe mënyra e pagimit të taksës për shërbimet e akomodimit në objekte hoteliere e turistike.

**Neni 2**  
**Përkufizimet**

Termet dhe shprehjet e përdorura në këtë projektligj kanë këtë kuptim:

**“Ministria”** nënkupton Ministrinë për Tregti dhe Industri.

**“Shërbimi i akomodimit”** nënkupton vendosjen/akomodimin në objekte hoteliere apo turistike vetëm për fjetje.

**“Person”** nënkupton personin fizik dhe juridik.

**“Taksa e shërbimit të akomodimit”** nënkupton taksën e veçantë nga çmimi i shërbimit, që paguhet nga personi që i shfrytëzon shërbimet e akomodimit në objekte hoteliere e turistike.

**“Objekti për akomodim”** nënkupton: hotelin, motelin, apartamentin turistik, pushimoren, kampin e bjeshkatarëve dhe të gjitha objektet e tjera që ofrojnë shërbime të akomodimit.

### **Neni 3**

#### **Pagesa e Taksës së Vendosjes**

1. Personi që shfrytëzon shërbime të akomodimit në objekte hoteliere ose turistike duhet ta paguajë taksën e shfrytëzimit të shërbimeve, ashtu siç është paraparë me këtë ligj.
2. Taksa nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të paguhet njëkohësisht me pagesën e shërbimeve të fjetjes në këto objekte.
3. Taksa e akomodimit në objekte hoteliere dhe turistike llogaritet në përqindje (%) të çmimit të shërbimeve të fjetjes që do të rregullohet me akt nënligjor të Ministrisë.
4. Mjetet e grumbulluara nga taksa e akomodimit paguhet në llogari të Buxhetit të Republikës së Kosovës.

### **Neni 4**

#### **Detyrimet e ofruesit të shërbimeve të akomodimit**

1. Ofruesi i shërbimeve të akomodimit është i detyruar ta bëjë pagesën e taksës së akomodimit në të njëjtën kohë me pagesën e çmimit të shërbimit të akomodimit.
2. Nëse ofruesi i shërbimeve të akomodimit nuk e bën pagesën e taksës së akomodimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, është i detyruar ta bëjë pagesën e kësaj takse nga mjetet e paguara për shërbimin e vendosjes.
3. Ofruesi i shërbimeve të akomodimit është i detyruar ta shënojë veçmas shumën e taksës së akomodimit në llogarinë e shërbimit të akomodimit. Nëse një person lirohet nga pagesa e taksës, sipas këtij ligji, duhet të shënohet baza sipas së cilës lirohet.
4. Ofruesi i shërbimit të akomodimit duhet t'i mbajë librat e evidencës për taksën akomodimit dhe për pagesën e saj.

5. Mbajtja e evidencave nga paragrafi 4 i këtij neni përcaktohet nga Ministria me akt nënligjor.

### **Neni 5**

#### **Detyrimi i raportimit nga ofruesi i shërbimeve të akomodimit**

Ofruesi i shërbimeve të akomodimit e ka për detyrë t'u paraqesë raport administratës tatimore dhe organit kompetent për punët e turizmit më së largu gjerë më datën 15 të muajit në vijim. Raporti duhet t'i përfshijë numrin e shfrytëzuesve të shërbimeve të akomodimit dhe shumën e taksës së paguar për akomodim për çdo muaj paraprak

### **Neni 6**

#### **Përcaktimi i taksës së akomodimit**

1. Taksa e akomodimit përcaktohet në bazë të përqindjes (%) së çmimit të shërbimeve të akomodimit.
2. Ministria nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e lartësisë së taksës së akomodimit duke i marrë parasysh llojin e objektit të akomodimit, kushtet dhe shërbimet që ofrohen.

### **Neni 7**

#### **Lirimi nga Pagesa e Taksës së Akomodimit**

1. Nga pagesa e taksës së akomodimit lirohen:
  - 1.1. fëmijët nën moshën dymbëdhjetë (12) vjeçare;
  - 1.2. personat me aftësi të kufizuara;
  - 1.3. personat që komisioni kompetent mjekësor i dërgon për kurim klimatik për të bërë banjë ose rehabilitim special;
  - 1.4. personat që bëjnë punë stinore e që e kanë lajmëruar akomodimin në organin kompetent të vendit turistik;
  - 1.5. ekskursionet shkollore, respektivisht nxënësit ose studentët, akomodimin e të cilëve e organizojnë shkollat ose fakultetet në kuadër të programeve të rregullta të manifestimeve kulturore e sportive;
  - 1.6. shtetasit e huaj që janë të liruar sipas traktateve ndërkombëtare nga taksa e akomodimit; dhe
  - 1.7. invalidët e luftës.
2. Personat sipas paragrafit 1 të këtij neni lirohen nga pagesa e taksës së akomodimit, nëse e paraqesin njërin nga dokumentet e identifikimit përkatës, si vijon:

- 2.1. certifikatën e lindjes;
  - 2.2. librezën e anëtarësisë së invaliditetit;
  - 2.3. vërtetimin e institucionit të arsimit.
3. Taksën e akomodimit, të zvogëluar për pesëdhjetë përqind (50 %), e paguajnë personat mbi moshën dymbëdhjetë (12) dhe nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare.

## **Neni 8**

### **Mbikëqyrja dhe Pagimi i Taksës së Akomodimit**

Administrata tatimore dhe organi kompetent për punët e turizmit, janë kompetentë për mbikëqyrjen e mbajtjes së evidencës përkatëse ndërsa administrata tatimore për arkëtimin e taksës së akomodimit.

## **Neni 9**

### **Dispozitat Ndëshkuese**

1. Për kundërvajtje dënohet me gjobë prej njëqind (100) deri treqind (300) euro personi fizik, përkatësisht prej pesëqind (500) deri tetëqind (800) euro personi juridik, nëse:
  - 1.1. se ka paguar taksën e akomodimit njëkohësisht me pagesën e shërbimit në pajtim me paragrafin 2 të nenit 3 të këtij ligji;
  - 1.2. se ka e evidencuar ndaras në faturë shumën e taksës së akomodimit ose se ka shënuar se në çfarë baze është liruar nga pagesa e saj, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 4 të këtij ligji;
  - 1.3. se ka mbajtur në rregull evidencën për shfrytëzuesin e shërbimit të akomodimit, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 4 të këtij ligji;
  - 1.4. në afat të paraparë nuk ia ka paraqitur organit kompetent tatimor raportin për numrin e shfrytëzuesve të shërbimeve të akomodimit dhe shumën e taksës së paguar të akomodimit, në pajtim me nenin 5 të këtij ligji;
  - 1.5. nëse nuk i paguan në afat të paraparë mjetet nga taksa e paguar e akomodimit, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 3 të këtij ligji.
  - 1.6. nëse nuk i paguan në afat të paraparë mjetet nga taksa e paguar e akomodimit, neni 6 i këtij ligji.

**Neni 10**  
**Dispozitat Kalimtare dhe të Fundit**

Ministria duhet të nxjerrë akt nënligjor për zbatimin e këtij ligji në afat prej tre (3) muajve pas shpalljes së tij.

**Neni 11**  
**Hyrja në Fuqi**

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/ L-027**  
**18 dhjetor 2008**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**